



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
SANKSIONEVE

Data: 07 Shkurt 2022

Nr: 06

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE  
NR. 2, DATË 05.02.2022 TË PARTISË DEMOKRATIKE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 07.02.2022, me pjesëmarrjen e:

Ledio BRAHO	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Partia Demokratike, përfaqësuar nga z. Marash Logu

**PALË E INTERESUAR:** Lëvizja Socialiste për Integrim, përfaqësuesi ligjor i partisë udhëheqëse të Koalicionit “Shtëpia e Lirisë” z. Altin Kaziaj

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 46, datë 04.02.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, (SH-L) për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”



**BAZË LIGJORE:** Neni 21, pika 1, shkronja “b”, neni 124/1, pika 2, neni 130, shkronja “b”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 9, pika 8 dhe neni 18 pika 1, shkronja “a”, të vendimit nr. 3, datë 6.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

### **Rrethanat e çështjes:**

1. Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 13 438, datë 20.01.2022, ka caktuar datën 6 Mars 2022, për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar për Bashkinë Shkodër, Bashkinë Dibër, Bashkinë Durrës, Bashkinë Vorë, Bashkinë Rrogozhinë dhe Bashkinë Lushnjë.
2. Lëvizja Socialiste për Integrim, me shkronja nistore “LSI”, nëpërmjet Kryetarit të saj, zj. Monika Kryemadhi, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022, administruar me nr. 297 prot., datë 28.01.2022. Pas verifikimeve përkatëse, kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur përputhet me kriteret e përcaktuara dhe si rrjedhojë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 34, datë 02.02.2022, e ka regjistruar si subjekt zgjedhor.
3. Partia Demokristiane e Shqipërisë, me shkronja nistore “PDK”, nëpërmjet Kryetarit të saj, z. Nard Ndoka, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022, administruar me nr. 328 prot., datë 29.01.2022. Pas verifikimeve përkatëse, kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur përputhet me kriteret e përcaktuara dhe si rrjedhojë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 38, datë 02.02.2022, e ka regjistruar si subjekt zgjedhor.
4. Me shkresën nr. 435 Prot., datë 31.01.2022, Lëvizja Socialiste për Integrim, në cilësinë e partisë udhëheqëse të koalicionit, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për regjistrim të Koalicionit Zgjedhor me emër “Shtëpia e Lirisë”, për zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022, me subjekte përbërëse:
  - Lëvizja Socialiste për Integrim;



- Partia Demokratike e Shqipërisë – Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit;
  - Partia Demokristiane.
5. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 46, datë 4.2.2022, ka regjistruar si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022, Koalicionin me emrin “Shtëpia e Lirisë” me shkronjat nistore “SH-L”. Subjektet zgjedhore, pjesë e këtij Koalicioni janë “Lëvizja Socialiste për Integrim” dhe “Partia Demokristiane e Shqipërisë”.
  6. Partia Demokratike, përfaqësuar nga z. Marash Logu, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore kundër vendimit nr. 46, datë 04.02.2022, të KSHZ. Kjo kërkesë është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore me nr. 02 regj., datë 05.02.2022, në respektim të kriterëve të përcaktuara.
  7. KAS-i caktoi me short z. Ledio Braho relator dhe vendosi zhvillimin e seancës përgatitore në datën 07.02.2022, ora 08:30. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj, pala ankuese, përfaqësuar nga z. Marash Logu dhe pala e interesuar, përfaqësuar nga z. Altin Kaziaj, të cilët ishin njoftuar rregullisht për zhvillimin e seancës.

### **KAS-i konstatoi:**

1. E drejta e një subjekti për të paraqitur kërkesë ankimore, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me identifikimin e legjitimitetit të tij. Subjektet kanë detyrimin të provojnë legjitimitetin e tyre, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis të drejtës apo interesit të pretenduar si të cënuar dhe veprimtarisë që kundërshtohet si e paligjshme.
2. Referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor, KAS çmoi së pari të marrë në shqyrtim çështjen e legjitimitetit aktiv. Që kërkesa ankimore të jetë e vlefshme nga pikëpamja formale procedurale duhet të plotësojë dy kushte themelore:
  - a) *interesi i ligjshëm;*
  - b) *legjitimiteti për të vepruar.*

Interesi i ligjshëm, sipas arsytimit të vendimit nr. 12, datë 24.06.2019 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, lind nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material dhe për këtë arsye, në

esencë presupozon njohjen e cënimit të një interesi. Interesi i ligjshëm i lind palës nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material të cënuar.

3. Kodi Zgjedhor në nenin 130, shkronja “b” parashikon se KAS merr vendim për pranimin ose mospranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon (...) legjitimitimin e ankuesit. E drejta e paraqitjes së ankimit lidhet me vërtetimin e ekzistencës së një interesi të ligjshëm të palës që ngre një pretendim, e cila kërkon të dëgjohet mbi themelin e këtij pretendimi.
4. Në momentin e regjistrimit pranë KQZ-së, çdo subjekt zgjedhor kryen këtë veprimtari me vullnetin e tij dhe pa patur dijeni paraprake se cili subjekt do të marrë pjesë në zgjedhje dhe sa do të jetë numri i tyre në këto zgjedhje. Në këtë rast çdo subjekt do të kishte interes të ligjshëm të paraqiste ankim, nëse, nga KQZ-ja, ky subjekt do të regjistrohej apo jo.
5. Ankimuesi, si subjekt zgjedhor është pranuar të regjistrohet nga KQZ si i tillë dhe për rrjedhojë nuk i është cënuar asnjë interes i tij. Regjistrimi nga KQZ i çdo subjekti apo mosregjistrimi i tij nuk cënon interesat e subjekteve të tjerë të cilëve u është pranuar ose jo regjistrimi si subjekt zgjedhor. Subjektet zgjedhore përfshirë partitë politike dhe koalicionet, regjistrohen pa marrë parasysh se sa dhe cilat janë subjektet që do të regjistrohen nga KQZ.
6. Vullneti që subjekti zgjedhor shpreh duke u rregjistruar, lidhet me interesin e tij të ligjshëm për të marrë pjesë në zgjedhje dhe kërkesa për mos regjistrimin e një subjekti tjetër zgjedhor në këtë rast, nuk përbën interesa të ligjshme të subjektit zgjedhor. Marrja apo mosmarrja pjesë në zgjedhje e çdo partie politike, apo bashkimi të subjekteve në formën e koalicioneve zgjedhore, nuk cënon interesat e ligjshme të ankimuesit si subjekt zgjedhor i rregjistruar. *(Shih vendimin nr. 1, datë 09.05.2019 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor)*
7. Duke qenë se objekt kundërshtimi është vendimi nr. 46, datë 04.02.2022 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, (Sh-L), për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”, subjekti ankues do të duhej të provonte ekzistencën e interesit të tij që cenohet nga vendimi të cilin ai kundërshton. Subjekti ankues nuk legjitimohet të kundërshtojë këtë vendim vetëm për faktin se është subjekt zgjedhor, pa provuar se preken interesa të tij të ligjshme, që është një nga kushtet themelore të legjitimitimit aktiv të palës që inicion një proces administrativ të shqyrtimit të një ankimi.

8. Pjesëmarrja e subjektit zgjedhor PD në fazën e shqyrtimit përpara KSHZ nuk mund të shërbejë si shkak legjitimimi “automatik”, për efekt të ankimit në KAS, si dhe në të njëjtën analogji përpara Kolegjit Zgjedhor. Në cdo rast do duhet që të vlerësohet, nëse kemi apo interes të ligjshëm të ankuesit pavarësisht qënies si palë në shqyrtimin administrativ.
9. Vlen të theksohet se është standarte dhe praktikë zgjedhore që disa subjekte politike kanë përfaqësim të akredituar në KQZ dhe marrin pjesë në procesin administrativ të vendimmarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për aktet kryesore të procesit, sikundër është regjistrimi i subjekteve zgjedhore. Po ashtu vlen të evidentohet në rastin konkret, subjekti zgjedhor Partia Demokratike (PD) ka ngritur një pretendim, për mos regjistrimin si subjekt zgjedhor pjesë e koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, SH-L të subjektit PD-Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, dhe vendimmarrja e KSHZ, qartësisht i dha zgjidhje edhe këtij kërkimi të subjektit Partia Demokratike.
10. Komisioneri me vendimmarrjen e tij ka regjistruar vetëm koalicionin e përbërë nga LSI-PDK, dhe në këtë moment pretendimi i ngritur nga PD në shqyrtimin administrativ para KSHZ, u zgjidh duke mos pasur asnjë “interes të ligjshëm” në kuptim të Kodit zgjedhor, ndaj regjistrimit të koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, i cili tashmë përbëhet nga dy subjektet zgjedhore LSI dhe PDK të cilat kanë identitet të qartë dhe të ndryshëm politik nga ankuesi PD. Pavarësisht nga marrëveshjet që këto subjekte kanë me njëra-tjetrën apo grupime të ndryshme, që kanë ose jo cilësitë e një subjekti politik, për efekt të kësaj gare zgjedhore, në fletën e votimit që do të kenë zgjedhësit në qendrën e votimit, do të pasqyrohet subjekti zgjedhor koalicioni “Shtëpia e Lirisë” me shkronjat nistore SH-L, me partitë përbërëse LSI-PDK.
11. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me Vendimin nr. 12, datë 24.06.2019, midis të tjerash përcakton se *“... sa i takon legjitimitit të paditësit, vlerësoj të theksoj se për të parashtruar përpara gjykatës një kërkim të caktuar është e nevojshme që të ketë interes. Ky interes është dobia personale për të kërkuar me anë të gjykatës njohjen ose rivendosjen e një të drejte të mohuar ose të shkelur. E drejta e një subjekti për të paraqitur një padi para gjykatës, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me identifikimin e legjitimitetit të tij. Subjektet që ushtrojnë të drejtën për të ngritur padi para gjykatës, kanë detyrimin të provojnë legjitimitetin e tyre, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis të drejtës apo interesit të pretenduar si të cënuar dhe veprimtarisë që kundërshtohet si e paligjshme...”* (Vendimi nr. 91, date 19.03.2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

12. Përfundimisht, në vlerësimin e KAS, ankimuesit nuk i është shkelur ndonjë e drejtë dhe as cenuar interesi i ligjshëm i pretenduar, e për pasojë nuk legjitimohet në kundërshtimin e vendimit të KSHZ-së. Regjistrimi i koalicionit “Shtëpia e Lirisë” (SH-L) për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, nuk ndryshon apo çënon kushtet e konkurrimit për asnjë nga subjektet e tjera zgjedhore.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, dhe 130, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 17, pika 3, shkronja “b” dhe neni 18, pika 1, shkronja “a”, të vendimit nr. 3, datë 6.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS-i

### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 02, datë 05.02.2022 të paraqitur nga Partia Demokratike.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Ledio            BRAHO            -            Relator (Kundër)**

**Elvin            LAKO            -            Anëtar**

**Elvis            ÇEFA            -            Anëtar**

**Ilirjan            RUSMALI            -            Anëtar (Kundër)**

**Koli            BELE            -            Anëtar**



## MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 2 të subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, me objekt *“Shfuqizimin e vendimit nr. 46, datë 04.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, (SH-L) për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”* (në vijim vendimi nr. 46, datë 04.02.2022), të paraqitur në KQZ në datën 05.02.2022, jemi kundër vendimit të shumicës për moskalimin për shqyrtim të kësaj kërkesë ankimore. Ne, anëtarët në pakicë, vlerësojmë se Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) duhet të pranonte për shqyrtim këtë kërkesë ankimore, ndaj ju paraqesim, në vijim, argumentet tona për këtë qëndrim.
2. Si fillim sqarojmë se me vendimin nr. 46, datë 04.02.2022, KSHZ ka vendosur ndër të tjera:
  - “1. Të regjistrojë si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022, Koalicionin e partive politike Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokristiane e Shqipërisë.
  2. Emri i koalicionit është “Shtëpia e Lirisë” me shkronja nistore “SH-L”.
  3. Partia udhëheqëse e koalicionit është “Lëvizja Socialiste për Integrim”.

Në përmbajtje të vendimit, në hyrje të tij, citohet se:

*“Në kërkesën e paraqitur në KQZ, janë përcaktuar*

**1. Partitë përbërëse të koalicionit:**

*- Lëvizja Socialiste për Integrim,*

***- Partia Demokratike e Shqipërisë – Komiteti i Përkohshëm i Rithemelimit,***

*- Partia Demokristiane.*

**2. Marrëveshja e koalicionit**

*3. Emri i koalicionit “Shtëpia e Lirisë” me shkronja nistore “SH-L”*

*4. Sigla e koalicionit”,*

3. Po ashtu, nga vendimi objekt shqyrtimi, rezulton se në seancën publike nëpërmjet të cilit është miratuar ky vendim, përveç përfaqësuesit të subjektit zgjedhor partia Lëvizja Socialiste për Integrim, është legjitimuar edhe përfaqësuesi i subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, i cili ka argumentuar se:

*“Përfaqësuesi i subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”, z. Logu, ngriti pretendimin për mos legjitimitimin e kërkesës së paraqitur nga LSI, pasi në momentin e paraqitjes së kërkesës me shkrim, kjo parti politike nuk kishte fituar ende statusin (cilësimin) e subjektit zgjedhor të*





regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Këtë status kjo parti e fitoi me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të datës 2 shkurt 2022. Duke qenë se kërkesa është paraqitur nga një subjekt që nuk ka legjitimitet për ta bërë atë, kërkesa duhet të rrëzohet, pretendon përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

Veçmas kësaj përfaqësuesi i Partisë Demokratike pretendoi se edhe në përmbajtjen e saj kjo kërkesë është në kundërshtim me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar – nga këtu e vijim referuar si Kodi Zgjedhor, përkatësisht nenin 66 të tij. Sipas z. Logu kërkesa e LSI çënon drejtpërdrejt interesin e subjektit zgjedhor “Partia Demokratike” pasi në të kërkohet që të bëhet regjistrimi i një koalicioni zgjedhor me përbërjen e Lëvizjes Socialiste për Integritet, Partisë Demokristiane dhe një subjekti me emërtimin Partia Demokratike e Shqipërisë – Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit.

Sipas përfaqësuesit të PD përdorimi i emrit të kësaj partie nga një subjekt tjetër përbën shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor, përkatësisht nenit 66 të tij. Vetë PD, pretendoi përfaqësuesi i saj, nuk është pjesë e asnjë koalicioni zgjedhor në këto zgjedhje dhe nuk ka asnjë vullnet për të hyrë në koalicion”.

4. Siç rezulton nga më sipër, së pari rezulton se subjekti zgjedhor Partia Demokratike është legjitimuar si palë në procedurën administrative të shqyrtimit të një kërkesë për regjistrim të një subjekti tjetër zgjedhor si koalicion pavarësisht se ajo nuk ishte pjesë e këtij koalicioni si dhe së dyti ka ngritur pretendime bazuar në dy elemente të regjistrimit të këtij koalicioni. Elementi i parë ka të bëjë me legjitimitimin e kërkuarit për depozitimin e një kërkesë të tillë jo brenda fashës së afatit të sanksionuar me Vendimin nr. 2, datë 22.01.2022 “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që do të zhvillohen më datë 6 mars 2022” të Komisionit Rregullator, ndërkohë që elementi dytë ka të bëjë me subjektet që janë pjesë e këtij koalicioni, ku një prej të cilëve emërtohet “Partia Demokratike e Shqipërisë – Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit”.
5. Në bazë të këtyre pretendimeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përmbajtje të vendimit objekt i këtij shqyrtimi ka arsyetuar se “Në vlerësim të sa u pretendua nga përfaqësuesit e dy subjekteve zgjedhorë në lidhje me kërkesën objekt shqyrtimi dhe të dokumentacionit që ka shoqëruar këtë kërkesë, bërë ky vlerësim bazuar në Kodin Zgjedhor, çmuj se pretendimet e përfaqësuesit të Partisë Demokratike janë vetëm pjesërisht të mbështetura në këtë Kod”. Përmbledhtazi, ai ka pranuar pretendimin e përfaqësuesit të PD në lidhje me palën Partia Demokratike e Shqipërisë – Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit duke mos e përfshirë si



një ndër subjektet pjesë e subjektit zgjedhor koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, por nuk ka pranuar pretendimin tjetër në lidhje me momentin procedural (që ka të bëjë me afatin) të depozitimit të kërkesës për regjistrimin e këtij koalicioni, çka për përfaqësuesin e PD duhet të sillte si pasojë edhe refuzimin për regjistrimin e këtij koalicioni.

6. Në vijim të vendimmarrjes së KSHZ, subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar edhe ankimin objekt i këtij shqyrtimi, ku sërish ka ngritur pretendime në lidhje me momentin procedural të depozitimit të kërkesës për regjistrimin e koalicionit nga subjekti zgjedhor LSI (pretendim ky që nuk është pranuar nga KSHZ) si dhe në lidhje me përmbajtjen e marrëveshjes së koalicionit dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj.
7. Duke qenë se shumica e anëtarëve të KAS ka arritur në përfundimin se kërkesa ankimore e subjektit zgjedhor PDSH nuk duhet të kalojë për shqyrtim administrativ për shkak të mungesës së interesit të ligjshëm të këtij subjekti në raport me regjistrimin e një subjekti zgjedhor në formën e koalicionit kur ajo vetë nuk është pjesë e tij, do analizojmë nenet 124, 124/1 dhe 130 të K.Zgjedhor. Më konkretisht, neni 124 pika 1 e K.Zgjedhor parashikon se *“1. Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit”*; neni 124/1 pika 2 fjalja e parë e këtij kodi parashikon se *“2. Kundër akteve të Komisionerit lejohet ankim në rrugë administrative në KAS nga palët që demonstrojnë një interes të ligjshëm për çështjen objekt i ankimit”*; si dhe neni 130 i tij parashikon se *“KQZ-ja merr vendim për pranimin ose mospranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon elementet e mëposhtme: a) kompetencën e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit; b) legjitimitimin e ankuesit; dhe c) respektimin e afateve ligjore për ankimin”*.
8. Nga nenet e sipërcituara del qartë që demonstrimi i interesit të ligjshëm është kusht *sine qua non* për legjitimitimin e një pale që ankimon një vendimmarrje të KSHZ në KAS.
9. Vlerësimi nëse një subjekt zgjedhor (neni 124 pika 1 e K.Zgjedhor) apo një palë e tretë (neni 124/1 pika 2 e K.Zgjedhor) ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Subjekti zgjedhor ose pala e tretë që vë në lëvizje KAS duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë dhe aktit administrativ që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i

drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike për paligjshmërinë e aktit administrativ që ka sjellë këtë cenim të interesit. Vetëm fakti se akti administrativ i kundërshtuar mund të ketë ose ka pasur një efekt çfarëdo për ankimuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e ankimit, por është e nevojshme të provohet se akti administrativ i kundërshtuar cënon interesat e ankimuesit, sipas përcaktimeve të bëra K.Zgjedhor.

10. Partia Demokratike e Shqipërisë është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022 me vendimin nr. 33, datë 02.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
11. Për rastin në shqyrtim, ashtu si edhe para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kërkuesi ka parashtruar para KAS argumente në lidhje me cenimin e interesave që vendimi nr. 46, datë 04.02.2022 passjell për subjektin zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë. Së pari ky subjekt zgjedhor është legjitimuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në ngritjen e pretendimeve në lidhje me regjistrimin e një koalicioni zgjedhor (Shtëpia e Lirisë) të kërkuar nga subjekti zgjedhor partia Lëvizja Socialiste për Integrim në lidhje me elemente procedurale siç janë legjitimiteti i LSI si subjekt zgjedhor në momentin e depozitimit të kërkesës si dhe afati në të cilin është depozituar kjo kërkesë. Në lidhje me këto elemente, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në vendimmarrjen e tij, i ka përshkruar si pretendime dhe ka argumentuar se përse ato nuk qëndrojnë. Po ashtu subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë ka ngritur pretendime edhe në lidhje me përmbajtjen e kërkesës për regjistrimin e këtij koalicioni dhe me marrëveshjen shoqëruese të tij duke arsyetuar ndër të tjera se “... në këtë pjesë do të ndalemi në ligjshmërinë e përmbajtjes së kërkesës dhe marrëveshjes së koalicionit. Konkretisht, në faqen e parë të kërkesës thuhet “Emri i koalicionit është “Shtëpia e Lirisë” (LSI-PD Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit-PDK).”; në faqen e dytë vijon: “**Partitë përbërëse të koalicionit janë: “Lëvizja Socialiste për Integrim; Partia Demokratike e Shqipërisë – Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit; Partia Demokristiane”.** Ndërsa, në marrëveshje thuhet “**Drejtuese politike e koalicionit është Partia Demokratike e Shqipërisë e përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit.**” (shih fq. 1); “**Partitë e Koalicionit, firmëtare të kësaj marrëveshje, janë “Partia Demokratike e Shqipërisë – Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit; nënshkruar nga Z. Flamur Noka”** (shih fq. 2-3)”. Më tej ankimuesi vijon pretendimin e tij me argumentin se “Por, ndryshe nga sa arsyeton Komisioneri, që përpiqet ta trajtojë marrëveshjen e koalicionit si një dokument formal, Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, imponojnë detyrimin edhe të verifikimit të përputhshmërisë së



*përmbajtjes të marrëveshjes me ligjin. Konkretisht, një nga kërkesat kryesore të nenit 65 të Kodit dhe nenit 2 të Udhëzimit nr. 01, datë 23.12.2020 është shprehja e qartë e vullnetit të partive pjesëmarrëse për të qenë pjesë e një koalicioni zgjedhor. Në përmbajtje të kërkesës dhe marrëveshjes ka referenca të qarta ndaj Partisë Demokratike të Shqipërisë, e cila për asnjë moment dhe në asnjë rast nuk ka shprehur vullnetin apo dëshirën për të qenë pjesë e një koalicioni të tillë. Një shprehje e tillë vullneti mund të bëhet vetëm nga kryetari i saj, Z. Lulzim Basha apo përfaqësuesit e autorizuar nga ana e tij, siç është përcaktuar në vendimin nr. 33, datë 02.02.2022 për regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë si subjekt zgjedhor”.*

12. Përveçse sa argumenton ankimuesi, fakti që ankimues është Partia Demokratike e Shqipërisë e po ashtu njëkohësisht koalicioni regjistrimin e të cilit ajo kundërshton bazohet në një marrëveshje që ka për palë edhe “Partia Demokratike e Shqipërisë – Komisioni i Rithemelimit” tregon që ankimuesi ka interes të ligjshëm në shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit administrativ objekt i këtij shqyrtimi. Për më tepër që neni 5 pika 3 fjalia e dytë e K.Zgjedhor parashikon se “Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ” si dhe neni 66 i tij parashikon se “Nëse dy parti politike ose koalicione kanë emër ose emblemë të njëjtë apo të ngjashme në atë masë sa që mund të shkaktojë konfuzion ose lajthitje të votuesve, atëherë KQZ-ja vendos cila parti ose cili koalicion ka të drejtë të përdorë emrin ose emblemën përkatëse për qëllime zgjedhore, duke marrë në konsideratë datën e themelimit ligjor të partive ose datën e regjistrimit të parë të koalicionit në KQZ. Për të përcaktuar datën e parë të regjistrimit të koalicioneve, KQZ-ja i referohet edhe zgjedhjeve të mëparshme”. Nga këto dispozita del qartë që ankimuesi ka interes të ligjshëm në rastin objekt shqyrtimi.

13. Në lidhje me jurisprudencën zgjedhore sa i përket ankimimeve nga një subjekt zgjedhor ndaj veprimtarisë së një subjekti zgjedhor në formën e një koalicioni pjesë e të cilit ai nuk është, i referohemi edhe vendimit nr. 9, datë 23.03.2021 të vetë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve ku ka legjitimuar subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë në ankimin e saj ndaj një vendimmarrjeje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për listën e kandidatëve të subjektit zgjedhor koalicionit PD-AN. Ky qëndrim (në lidhje me interesin e ligjshëm) u konfirmua dhe nga Kolegji Zgjedhor me vendimin nr. 3, datë 29.03.2021 të tij. Madje, Kolegji Zgjedhor, duke argumentuar se “... nevojat e secilit subjekt zgjedhor, kur merr pjesë në garë plotësohen në përputhje me ligjin zgjedhor, i cili gjen njësoj zbatim edhe prej subjekteve të

*tjera zgjedhore*” i ka bërë një interpretim të zgjeruar interesit të ligjshëm të subjekteve zgjedhore në zgjedhje.

14. Prandaj, ne anëtarët në pakicë të KAS, bazuar edhe në jurisprudencën e këtij komisioni si dhe të Kolegjit Zgjedhor, për legjitimimin e ankimuesit, arrijmë në përfundimin se edhe në çështjen konkrete ankimuesi ka arritur të provojë interesin e tij për ta vënë në lëvizje KAS, prandaj legjitimohet *ratione personae* për të iniciuar kontrollin e ligjshmërisë së vendimit të KSHZ objekt shqyrtimi.

**Ledio BRAHO - Relator**

**Ilirjan RUSMALI - Anëtar**